



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË 2020 – 2021

Prishtinë, mars 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive	1
1. Hyrje	3
2. Baza ligjore për vlerësimin e konkurrencës së tregut	4
3. Përshkrimi i tregut të energjisë elektrike në Kosovë	6
3.1. Kapacitetet e interkoneksionit	8
4. Qasja e vlerësimit të konkurrencës së tregut	11
4.1. Përqindja e tregut, raporti i përqendrimit dhe indekset hhi	12
4.2. Treguesi i furnizuesit kryesor (psi)	14
4.3. Indeksi i furnizimit rezidual (rsi)	15
5. Vlerësimi i konkurrencës në tregun me shumicë të energjisë elektrike	16
5.1. Përshkrimi i tregut me shumicë në Kosovë	16
5.1.1. Marrëveshja e furnizimit me shumicë ndërmjet kek-ut dhe furnizuesit të shërbimit universal	17
5.2. Llogaritja e indekseve për tregun me shumicë në Kosovë	19
5.2.1. Përqindja e tregut	19
5.2.2. Indeksi hhi	21
5.2.3. Treguesi i furnizuesit kryesor (psi)	23
psi është llogaritur për kek-un (kosova a + kosova b) dhe hc ujmani. Psi është llogaritur edhe për tc kosova a dhe tc kosova b, për të analizuar fuqinë e tregut të secilit termocentral veç e veç.	23
5.2.4. Indeksi i furnizimit rezidual	24
5.3. Ndikimi i bashkimit të tregut me shqipërinë në konkurrencën e tregut me shumicë të energjisë elektrike	26
6. Vlerësimi i konkurrencës në tregun me pakicë të energjisë elektrike	28
6.1. Përshkrimi i tregut me pakicë të energjisë elektrike	28
6.1.1. Furnizimi i shërbimit publik dhe derregullimi i përdoruesve fundorë	29
6.1.2. Furnizuesi i mundësisë së fundit	30
6.2. Pjesëmarrja në treg dhe inteksi hhi	31
6.3. Nivelet e ndërrimit të furnizuesit	33
7. Përfundime	35

Figurat

Figura 1. Shtirja kohore e reformave të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.	6
Figura 2. Ngarkesa maksimale, fuqia e instaluar dhe raporti ndërmjet kapaciteteve nominale të transmetimit të interkonektorëve dhe ngarkesës maksimale/fuqisë së instaluar të gjeneratorëve në 6 vendet e BP	10
Figura 3. Qasjet e vlerësimit të konkurrencës së tregut dhe të zbulimit të fuqisë së tregut.	11
Figura 4. Energjia elektrike lokale bruto e prodhuar në Kosovë në nivel të transmetimit, 2021	16
Figura 5. Çmimi i energjisë elektrike të shitur në HUPEX dhe prej KEK-ut te FSHP-ja.....	18
Figura 6. Destinacioni i prodhimit neto të energjisë elektrike të KEK-ut.....	19
Figura 7. Pjesëmarrja në treg për nga vëllimi i energjisë elektrike të gjeneruar	20
Figura 8. Numri i kompanive kryesore gjeneruese të energjisë elektrike dhe pjesëmarrja e tyre kumulative në treg.	21
Figura 9. Vlerat e HHI-së së prodhimit vendor të energjisë elektrike për Kosovën.	22
Figura 10. Vlerat e llogaritura të HHI-së për prodhimin e energjisë elektrike në vendet evropiane.	23
Figura 11. PSI-ja e agreguar për prodhuesit e energjisë elektrike në Kosovë. Të dhënat për 2018 - 2021.	24
Figura 12. Përqindja kumulative e RSI-së për KEK-un dhe HC Ujmani, 2018-2021	25
Figura 13. Përqindja kumulative e RSI-së për KEK-un, 2018 - 2021	25
Figura 14. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të energjisë elektrike për vitin 2021 në Shqipëri.	26
Figura 15. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të energjisë elektrike për vitin 2021 në tregun e përbashkët Shqipëri-Kosovë.	27
Figura 16. Ndikimi i tregut të përbashkët me shumicë në indeksin HHI.	27
Figura 17. Numri i shitësve kryesorë me pakicë të energjisë elektrike dhe pjesëmarrja e tyre kumulative në treg, 2019 dhe 2021 për Kosovën.	31
Figura 18. HHI dhe CR3 për tregun e amvisërive bazuar në pikat matëse në energji elektrike – 2018-2020	32
Figura 19. HHI dhe CR3 për tregun jo të amvisërive në energjinë elektrike – 2018-2020.....	32

Tabelat

Tabela 1. Afatet e respektuara dhe të shtyra në liberalizimin e tregut me pakicë. Në ngjyrë të gjelbër (afati i respektuar), në ngjyrë të kuqe (afati nuk është respektuar)	8
Tabela 2. Kapacitetet e interkoneksionit në Kosovë.....	9

shkurtesat

ALPEX	Bursa shqiptare e energjisë
RP	Raporti i përqendrimit
TKE	Traktati i komunitetit të energjisë
ZRRE	Zyra e rregullatorit për energji
PPE	Prodhuesi i pavarur i energjisë
OSD	Operatori i sistemit të distribuimit
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
HC	Hidrocentrali
HUPEX	Bursa hungareze e energjisë elektrike
KEDS	Kompania kosovare e shpërndarjes dhe shërbimeve të energjisë elektrike Kosovo
KEK	Korporata energjetike e Kosovës
KESCO	Kompania kosovare e furnizimit të energjisë elektrike
KOSTT	Operatori i sistemit, transmetimit dhe tregut të energjisë elektrike të Kosovës
Kv	Kilovolt
MW	Megavat
PSI	Treguesi i furnizuesit kryesor
RSI	Indeksi i furnizimit rezidual
FMF	Furnizuesi i mundësisë së fundit
OST	Operatori i sistemit të transmetimit
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
FSHU	Furnizimi i shërbimit universal
TV	Termocentrali virtual
FE	Fuqia e erës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron një analizë të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë në Kosovë gjatë viteve 2020 dhe 2021. Ai bazohet në analizën e strukturës së tregut dhe indekseve të përqendrimit të tregut si përqindja e tregut, HHI, raporti i përqendrimit (RP), Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI).

Detyrat dhe funksionet e Rregullatorit janë të përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, i cili ndër të tjera përfshin krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë. Për më tepër, sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, neni 26, Rregullatori, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Zyrën e Ndhmës Shtetërore, së paku një herë në dy (2) vjet kryen hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Tregu me shumicë i energjisë elektrike

Tregu me shumicë i energjisë elektrike aktualisht funksionon me kontrata dypalëshe, pa tregje të organizuara një ditë para dhe brenda ditës. Në Kosovë, KEK-u ka mbajtur një përqindje pothuajse konsistente të tregut prej 95-97% gjatë viteve. Indeksi HHI për tregun me shumicë ishte 9371 në vitin 2020 dhe 9070 në vitin 2021, duke përfaqësuar një treg shumë të përqendruar. Energjia elektrike e prodhuar nga KEK-u i shitet me prioritet Ofruesit të Shërbimit Universal (75.7% e energjisë elektrike neto të prodhuar nga KEK-u në vitin 2021). Energjia e mbetur e KEK-ut shitet për të mbuluar humbjet në rrjet në nivelet e transmetimit (3.0% në vitin 2021) dhe shpërndarjes (9.4% në vitin 2021) dhe në tregjet e eksportit (11.8% në vitin 2021).

Në krahasim me ngarkesën maksimale, kapacitetet nominale të transmetimit të Kosovës janë 3.71 herë më të larta, dhe në krahasim me fuqinë e instaluar të gjeneratorëve janë 3.61 herë më të larta. Kështu, e gjithë kërkesa maksimale e Kosovës teorikisht mund të mbulohet nga importet, gjë që kufizon shtrirjen e fuqisë së tregut të kompanive prodhuese vendore në çmimin e energjisë elektrike të importuar.

Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) tregon se gjatë të gjitha orëve KEK-u konsiderohet si thelbësor (i nevojshëm për të zëvendësuar importet), ndërsa HC Ujmani konsiderohet si thelbësor vetëm gjatë 50% të orëve në vitin 2020 dhe 61% të orëve në vitin 2021. Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI) tregon se KEK-u ka një shkallë të lartë të fuqisë në treg gjatë të gjitha orëve të vitit. HC Ujmani mund të ushtrojë fuqi të kufizuar në treg për shkak të prodhimit të kufizuar.

Një treg i përbashkët me Shqipërinë, në të cilin e gjithë energjia elektrike tregtohet përmes një burse të përbashkët të energjisë elektrike, do të reduktonte përqendrimin e tregut me shumicë në Kosovë dhe Shqipëri.

Tregu me pakicë i energjisë elektrike

Aktualisht janë 8 furnizues të licencuar në Kosovë, ku vetëm një është aktiv (KESCO). Në vitin 2020 dhe 2021, KESCO funksionoi si Furnizues i Shërbimeve Publike, Furnizues i Mundësisë së Fundit dhe si furnizuesi i vetëm aktiv në tregun e derregulluar. Kështu, KESCO ka 100% të tregut me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, për konsumatorët e amvisërisë dhe industrialë, që paraqet një indeks HHI prej

10,000. Asnjë konsumator nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ndërrimit të furnizuesit në asnjërin segment të tregut me pakicë.

Për periudhën e shqyrtimit, bazuar në treguesit e analizuar, tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë shfaq mungesë konkurrence dhe përqendrim të lartë në treg.

1. HYRJE

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë ka pësuar disa reforma gjatë dy dekadave të fundit. Tregu i energjisë elektrike kaloi nga një treg shtetëror i integruar vertikalisht në një kompani të integruar vertikalisht që ofron prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike. Ky proces solli themelimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe segmentimin e tregut të energjisë elektrike.

Në vitin 2016 janë miratuar Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë. Për më tepër, legjislacioni dytësor është harmonizuar gjithashtu për të mundësuar funksionimin e tregut të energjisë në përputhje me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe me Direktivën nr. 2009/72/KE, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren nr. 714/2009/KE për kriteret e qasjes në rrjet për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

ZRRE synon të krijojë konkurrencë në segmentet e tregut që nuk janë monopole natyrore, si në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike. Një treg konkurrues siguron shpërndarje efikase të burimeve ndërmjet akterëve të tregut. Për shkak të natyrës dhe historisë së tregut të energjisë elektrike në Kosovë, futja e konkurrencës në çdo nivel është e vështirë.

Vlerësimi ofron një analizë të thellë të funksionimit të tregut të energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë në Kosovë. Për më tepër, raporti vlerëson nivelin aktual të konkurrencës në segmentet e prodhimit dhe furnizimit në Kosovë dhe e krahason atë me vitet e mëparshme dhe vendet e tjera.

Vlerësimi i konkurrencës bazohet në tregues të përcaktuar si: përqindja e tregut, raportet e përqendrimit, indeksi HHI, Treguesi i Furnizuesit Kryesor dhe Indeksi i Furnizuesit Rezidual.

Të dhënat e përdorura në këtë raport përqendrohen në konkurrencën e tregut në vitin 2020 dhe 2021. Ai përdor gjithashtu të dhëna të mëparshme historike.

Raporti përfundon me vlerësimin nëse ka konkurrencë efektive në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë. Për më tepër, karakteristikat e tregut të cilat mund të pengojnë konkurrencën efektive janë paraqitur në këtë raport dhe janë analizuar në thellësi në raportin mbi "Pengesat ndaj liberalizimit të tregut me pakicë në Kosovë".

2. BAZA LIGJORE PËR VLERËSIMIN E KONKURENCËS SË TREGUT

ZRRE është agjenci e pavarur, e ndarë ligjërisht dhe funksionalisht nga çdo person tjetër fizik ose juridik. Detyrat dhe funksionet e ZRRE-së janë të përcaktuara në Ligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, i cili ndër të tjera përfshijnë: krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, krijimin dhe funksionimin e tregjeve efikase, transparente dhe jodiskriminuese të energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve si dhe dhënien e licencave për kryerjen e veprimtarive në sektorin e energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimin e tregut dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme bazuar në metodologjinë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës mbizotëruese dhe praktikave jokonkurruese nga sipërmarrjet energjetike, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë.

Neni 15.1, nën-paragrafi 1.2, i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ndër të tjera, përcakton përgjegjësinë për vlerësimin e funksionimit të tregut dhe konkurrencës, i cili thotë: për të përmbushur detyrat e veta, ZRRE ka autoritetin dhe përgjegjësinë si në vijim:

“1.2. të përkujdeset për funksionim transparent dhe jodiskriminues të tregjeve të energjisë, duke u bazuar në parimet e tregut të lirë, sa u përket aktiviteteve konkurruese dhe aktiviteteve të rregulluara;”

Një nga përgjegjësitë e ZRRE-së, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve të cilëve u takon shërbimi universal, është që t'ua ngarkojë detyrimin e shërbimit publik ndërmarrjeve energjetike. Për të ngarkuar ndërmarrjet energjetike me këtë obligim, ZRRE-ja duhet të veprojë në përputhje me nenin 51.1, nën-paragrafi 1.3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i cili ndër të tjera thotë:

“1.3. të bëjë vlerësimin e rregullt të efekteve të mundshme të obligimeve të shërbimit publik mbi konkurrencën vendore dhe ndërkombëtare në tregjet e energjisë, si dhe të konsiderojë nëse këto obligime duhet rishqyrtuar apo jo.

Për më tepër, dhe për të siguruar që konsumatorët të përfitojnë përmes funksionimit efikas të tregut të tyre kombëtar, ZRRE-ja sipas nenit 15.1, nën-paragrafi 1.17, duhet:

“1.17. të sigurojë se konsumatorët përfitojnë nga funksionimi efikas i tregut kombëtar të tyre, nga promovimi i konkurrencës efektive dhe nga ofrimi i ndihmës për të siguruar mbrojtje të konsumatorëve;”

Bazuar në të drejtat e parapara me nenin 24.1 të Ligjit për Energjinë, ZRRE-ja zbaton masa që synojnë parandalimin e shkeljeve të dispozitave të Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë, nenet 22 dhe 23, të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e kufizimeve të konkurrencës, përkatësisht duke ndaluar keqpërdorimin e pozitës mbizotëruese në treg.

Ndërsa, sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, neni 26, ndër të tjera parashihet si në vijim:

"1. Rregullatori, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndhmës Shtetërore, së paku çdo dy (2) vite duhet të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike."

"1. Rregullatori mund të përcaktojë masa të nevojshme dhe proporcionale të obligimeve të shërbimit publik, me qëllim të nxitjes të konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut të energjisë elektrike. Këto masa mund të përfshijnë programet për ofrimin në treg të sasive të caktuara të energjisë elektrike, sipas të cilat subjektet obligohen të shesin ose të vënë në disponim sasi të caktuara të energjisë elektrike ose mundësimin e qasjes në një pjesë të kapaciteteve të tyre prodhuese, furnizuesve të interesuar, për një periudhë kohore të caktuar."

Ndërsa Ligji për Energjinë, përkatësisht neni 24, i përcakton kompetencat e ZRRE-së dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës sa i përket konkurrencës, si në vijim:

"2. Nëse Rregullatori mbledh dëshmi të arsyeshme mbi një shkelje aktuale ose të dyshuar sipas dispozitave të nenit 22 dhe 23 të këtij ligji nga një ndërmarrje e energjisë, Rregullatori i dorëzon këto dëshmi në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës iniciuon një hetim të shkeljes së pohuar dhe merrë çfarëdo masa zbatuese të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për korrigjimin ose adresimin e shkeljes së pohuar në përputhje me Ligjin për Konkurrencën."

"3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kryen një hetim, qoftë në bazë të informatave të marra nga Rregullatori ose nga çfarëdo burimi tjetër, përfshirë edhe me veprime të veta, mbi një shkelje të pohuar ose potenciale nga një ndërmarrje e energjisë të Ligjit për Konkurrencën sipas nenit 22 apo 23 të këtij ligji, Rregullatori do të ndihmojë Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në kryerjen e këtij hetimi dhe vlerësimin e shkeljes së pohuar."

Sipas nenit 15.7, nën-paragrafi 7.3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, është detyrë e ZRRE-së që të bashkëpunojë me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për të siguruar:

"7.3. se krijohet dhe mirëmbahet tregu konkurrues, aty ku është e mundshme, si dhe t'i pengojë e t'i dënojë veprimet kundërkonkurruese, në bashkëpunim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës;"

ZRRE-ja dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në shtator 2020, siç kërkohet me nenin 24.1 të Ligjit për Energjinë, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dhe ranë dakord për të përcaktuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet dy institucioneve që kanë të bëjnë me monitorimin e konkurrencës në tregun e energjisë.

3. PËRSHKRIMI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Reformat energjetike në Kosovë filluan me themelimin e Zyrës së pavarur të Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në vitin 2004. Reformat u pasuan me ndarjen e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), subjekt shtetëror i integruar vertikalisht. KEK-u kishte mbikëqyrur prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike. Në vitin 2006, procesi i ndarjes çoi në krijimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), përkatësisht KOSTT-it i cili gjithashtu shërben si Operator i Tregut (OT). KOSTT-i dhe KEK-u mbeten në pronësi publike.

Procesi i ndarjes vazhdoi me privatizimin e shërbimeve të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut në vitin 2013. Shpërndarja dhe furnizimi iu nënshtruar shturjes ligjore në vitin 2015, ku u themelua OST-ja (KEDS) dhe furnizuesi aktual (KESCO). Ky proces hapi rrugën për krijimin e shtatë furnizuesve të tjerë.

Që nga viti 2017, çmimet e prodhimit në Kosovë janë të derregulluara dhe caktohen përmes kontratave dypalëshe, dhe në vitin 2019 HC Ujmani filloi të ofrojë prodhimin e tij përmes procedurave konkurruese.




Figura 1. Shtrirja kohore e reformave të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Tregu me shumicë i energjisë elektrike aktualisht vepron me kontrata dypalëshe. Tregjet *një ditë para* dhe *brenda ditës* nuk janë krijuar ende në Kosovë. Energjia elektrike importohet nga tregjet rajonale *një ditë para* ose *brenda ditës* me kontrata dypalëshe.

Energjia e prodhuar nga KEK-u i shitet me prioritet Furnizuesit të Shërbimit Universal. Gjatë procesit të ndarjes dhe privatizimit, është nënshkruar një Marrëveshje për furnizim me shumicë¹ ndërmjet KEK-ut

¹ https://me.rks-gov.net/repository/docs/Bulk_Supply_Agreement.pdf

dhe KEDS-it aktual (që më vonë u nda ligjërisht në KEDS dhe KESCO). Sipas nenit 5.2. të kësaj marrëveshjeje, KEDS/KESCO mund të blejë energji elektrike nga KEK-u, për qëllime të Furnizimit me Shërbimin Universal me prioritet. Energjia e mbetur e prodhuar nga KEK-u shitet për të mbuluar humbjet në rrjet, në nivelet e transmetimit (KOSTT) dhe shpërndarjes (KEDS), me çmime të negociuara me secilën palë. Teprica e energjisë nga KEK-u tregtohet në treg sipas procedurës së tregtimit të energjisë elektrike.²

Energjisë së ripërtëritshme të prodhuar në Kosovë i garantohet dërgimi me prioritet, dhe kompensohet sipas skemave tarifore *feed-in* të furnizimit (FIT) nga të gjithë përdoruesit fundorë proporcionalisht. Kështu, energjia e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme nuk u nënshtrohet procedurave të tregtimit të energjisë elektrike në treg.

Sipas nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike, shërbimi universal është një e drejtë që mund ta gëzojnë të gjithë konsumatorët e amvisërisë ose jo të amvisërisë që kanë një qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milionë euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës.

Sipas Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, ZRRE në prill 2017³ ka vendosur obligimin e shërbimit publik ndaj KESCO-s për të furnizuar me energji elektrike konsumatorët që kanë të drejtën e shërbimit universal, ndërsa për një periudhë kalimtare nën obligimin e shërbimit universal janë përfshirë edhe konsumatorët e kyçur në 110 kV, 35 V dhe 10 kV.

Sa i përket sektorit të shitjes me pakicë, në vitin 2017 ZRRE ka nxjerrë “Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë”⁴. Neni 8 i këtij udhëzuesi përcakton data specifike për derregullimin gradual të çmimeve të konsumatorëve – periudhën kalimtare. Konsumatorët e lidhur në 220 kV ishin të parët që hynë në tregun e derregulluar, të ndjekur nga konsumatorët në 110 kV (prill 2017), dhe derregullimi i pjesshëm i konsumatorëve të lidhur në 35 kV dhe 10 kV (prill 2018). Për më tepër, udhëzimi përmend se të gjithë konsumatorët fundorë kanë të drejtë të furnizohen me tarifa konkurruese të tregut. ZRRE gjithashtu ka miratuar disa rregulla për të mundësuar konkurrencën në tregun me pakicë, si Rregulla e Ndërrimit të Furnizuesit⁵, Rregulla për Përcaktimin e të Hyrave për Furnizuesin e Shërbimeve Universale⁶ dhe Rregulla për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.⁷

Një përmbledhje e afateve të planifikuara dhe vonesave është paraqitur në Tabela 1. Arsyeja e vonesave në vitin 2017 dhe 2018 i atribuohet mungesës së konkurrencës në treg. Afati i 31 marsit 2020 dhe 2021 po ashtu janë shtyrë me kërkesë të KESCO-s që të vazhdojë furnizimin e konsumatorëve në 35kV dhe 10 kV në kuadër të Shërbimit të Furnizimit Universal. Arsyetimi për këtë shtyrje ishte ndikimi i pandemisë COVID në financat e kompanive.

² KOSTT, Procedura për tregtimin e energjisë elektrike, 2018

³ ZRRE, Decision V_916_2017

⁴ ZRRE, Udhëzues për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, 2017

⁵ ZRRE, Rregulla për ndërrimin e furnizuesit, 2016

⁶ ZRRE, Rregulla për përcaktimin e të hyrave të furnizuesit të shërbimit universal (Rregulla e çmimoreve të FSHU-së), 2017

⁷ ZRRE, Rregulla për furnizuesin e mundësisë së fundit, 2017

Afati i fundit (31 mars 2021) është shtyrë për një kohë të pacaktuar, pa vendim të bordit të ZRRE-së por me kërkesë në KESCO, pasi në atë kohë ZRRE nuk kishte një bord funksional të mandatuar për të marrë një vendim të tillë.

Tabela 1. Afatet e respektuara dhe të shtyra në liberalizimin e tregut me pakicë. Në ngjyrë të gjelbër (afati i respektuar), në ngjyrë të kuqe (afati nuk është respektuar)

	Udhëzuesi për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë (2017) ⁸	V_916_2017 ⁹	Ndryshimi i Udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë (2018) ¹⁰	Kërkesa ndaj KESCO-s (2021) ¹¹
220 kV	Janar 2017			
110 kV	31 mars 2017	31 mars 2018		
35 kV	31 mars 2018		31 mars 2020	E pakufizuar
10 kV	31 mars 2018		31 mars 2021	E pakufizuar

3.1. KAPACITETET E INTERKONEKSIONIT

BE-ja ka vendosur objektiva të interkoneksionit për të gjitha shtetet anëtare prej 10% në vitin 2020 dhe 15% në vitin 2030. Me fjalë të tjera, shtetet anëtare duhet të kenë kapacitete ndërkufitare të interkoneksionit që mundësojnë transportin e të paktën 10% (15% në 2030) të energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet vendore në vendet fqinje.¹²

Kosova ka kapacitete interkoneksioni prej 400 kV me të gjitha vendet fqinje, dhe interkoneksione shtesë prej 220 kV me Shqipërinë dhe Serbinë. Kapacitetet e interkoneksionit të Kosovës janë paraqitur në

⁸ ZRRE, Udhëzues për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, 2017

⁹ ZRRE, Vendimi V_916_2017

¹⁰ ZRRE, Udhëzues për ndryshimin e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, ndryshuar më 13 qershor 2018 dhe 30 tetor 2018

¹¹ <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/zrre-kerkon-nga-kesco-te-vazhdoj-ofrimin-e-sherbimit-universal-edhe-konsumatoret-qe-ishte-parapare>

¹² Komisioni Evropian, Caqet e interkoneksionit të energjisë elektrike

Tabela 2.

Tabela 2. Kapacitetet e interkoneksionit në Kosovë¹³

Kufijtë	Niveli i voltazhit (kV)	Kapaciteti i instaluar (MVA)	Kapaciteti nominal i transmetimit (MW)	Kapaciteti i transferuar neto (NTC) (MW)
Kosovë – Shqipëri	400	1317	1185	600
	220	300	270	
Kosovë – Mali i Zi	400	1317	1185	400
Kosovë – Serbi	400	1317	1185	600
	220	300	270	
Kosovë – Maqedoni e Veriut	400	1218	1096	400
GJITHSEJ		5769 MW	5192 MW	2000 MW

Ngarkesa maksimale, fuqia totale e instaluar dhe raportet ndërmjet kapaciteteve nominale të transmetimit të interkonektorëve dhe ngarkesës maksimale/fuqia e instaluar e gjeneratorëve në BP 6 janë paraqitur në Figura 2.

¹³ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Caqet e interkoneksionit të energjisë elektrike në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. 2021




Figura 2. Ngarkesa maksimale, fuqia e instaluar dhe raporti ndërmjet kapaciteteve nominale të transmetimit të interkonektorëve dhe ngarkesës maksimale/fuqisë së instaluar të gjeneratorëve në 6 vendet e BP¹⁴

Siç shihet në figura, të gjitha vendet e BP 6 kanë kapacitete të konsiderueshme interkoneksioni me vendet fqinje. Në krahasim me ngarkesën maksimale (1,398 MW në vitin 2021), kapacitetet nominale të transmetimit të Kosovës janë 3.71 herë më të larta, dhe në krahasim me fuqinë e instaluar të gjeneratorëve është 3.61 herë më e lartë.

E gjithë kërkesa maksimale e Kosovës teorikisht mund të mbulohet nga importet, gjë që kufizon shtrirjen e fuqisë së tregut të kompanive prodhuese vendore në çmimin e energjisë së importuar.

Furnizuesit në Kosovë kanë qasje në tregjet ndërkombëtare me shumicë si HUPX, SEEPEX, EEX, etj., përmes interkoneksioneve me vendet fqinje dhe ndërlidhjeve të tyre me vendet evropiane (Kroacia, Hungaria, Greqia, Italia, Bullgaria dhe Rumania).

¹⁴ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Caqet e interkoneksionit të energjisë elektrike në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. 2021

4. QASJA E VLERËSIMIT TË KONKURRENCËS SË TREGUT

Janë disa qasje për të vlerësuar konkurrencën në treg në sektorin e energjisë elektrike dhe për të zbuluar fuqinë e tregut. Qasjet e ndryshme për zbulimin e fuqisë së tregut janë paraqitur në Figura 3.




Figura 3. Qasjet e vlerësimit të konkurrencës së tregut dhe të zbulimit të fuqisë së tregut.¹⁵

Duke pasur parasysh se tregu me shumicë i Kosovës bazohet në kontrata dypalëshe me likuiditet të kufizuar si dhe në mungesë të të dhënave për kostot dhe ofertat, vlerësimi i konkurrencës do të bazohet në indekset strukturore. Pasi analiza e kërkesës reziduale, e cila mat nxitjen e një kompanie për të ushtruar fuqinë e tregut, nuk mbështetet në tregje likuide, me të dhëna për çmimin e ofertave dhe nuk ndihmon në matjen e konkurrencës në treg, nuk do të analizohet.

Për tregun me shumicë do të analizohen indekset e mëposhtme:

- Përqindja e tregut
- HHI
- Raporti i përqendrimit (CRn)
- Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI)
- Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI)

Ndërsa për tregun me pakicë do të analizohen indekset e mëposhtme:

¹⁵ Pham, T., 2019. Market Power Issues in Liberalized Wholesale Electricity Markets: A Review of the Literature with a Look into the Future. *Revue d'économie politique*, 129(3), p.325.

- Përqindja e tregut
- Raporti i përqendrimit
- HHI

Përcaktimi i të dhënave do të jetë për orë dhe vjetor. Të dhënat për orë për prodhimin dhe kërkesën janë siguruar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (KOSTT). Gjithashtu do të përmendet numri i furnitorëve dhe tarifat e kalimit në tregun me pakicë. Të gjithë indekset janë llogaritur *ex-post*.

Rezultatet do të krahasohen me studime të tjera të ngjashme në juridiksione/vende të ndryshme.

4.1. PËRQINDJA E TREGUT, RAPORTI I PËRQENDRIMIT DHE INDEKSET HHI

Përqindja e tregut, raportet e përqendrimit dhe indekset HHI janë metodat më të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për të vlerësuar konkurrencën në tregje. Ideja prapa përdorimit të këtyre indekseve është se një treg më i përqendruar çon në më pak konkurrencë dhe gjasë të shtuar që pjesëmarrësit me përqindje të lartë tregu të ushtrojnë fuqi të tregut.

Për këto indekse është e rëndësishme të përcaktohet produkti dhe rajoni gjeografik.

Në tregjet me shumicë të energjisë elektrike, produkti mund të përfshijë prodhimin e energjisë, energjinë plus rezervat, kapacitetet afatshkurta dhe kapacitetet afatgjata.¹⁶ Për qëllime të këtij studimi ne konsiderojmë se produkti është i kufizuar në vëllimet e prodhimit të energjisë.

Rajoni gjeografik i konsideruar është Kosova dhe nuk supozohen çështje të rëndësishme të mbipopullimit brenda kufijve të vendit. Për më tepër, kur analizohet ndikimi i lidhjes së tregut me Shqipërinë në konkurrencën në tregun e shitjes me shumicë, Kosova dhe Shqipëria do të konsiderohen si një rajon gjeografik, duke supozuar se nuk ka probleme të rëndësishme të mbingarkesës në nivel transmetimi.

Për të analizuar tregun me pakicë, ne kemi parasysh 2 produkte të ndryshme: 1) numrin e konsumatorëve me pakicë të shërbyer nga një furnizues; dhe 2) vëllimin e energjisë elektrike të shërbyer nga një furnizues. Baza e konsumatorëve do të përcaktohet veçmas për ekonomitë familjare dhe industrinë.

Përqindja e tregut e një kompanie përcaktohet si përqindja e tregut që shërbehet nga kompania. Në rastin e tregut me shumicë, ajo është raporti ndërmjet energjisë së prodhuar nga kompania dhe totalit të energjisë së prodhuar në vend. Ndërsa, për tregun me pakicë përkufizohet si raporti ndërmjet numrit/energjisë së konsumatorëve të shërbyer dhe numrit total/energjisë së konsumatorëve me pakicë. Për shembull, një kompani që prodhon 10 MWh/vit energji elektrike në një treg prej 100 MWh/vit, ka një përqindje tregu prej 10%.

Raporti i përqendrimit është përqindja e kombinuar e tregut të kompanive më të mëdha në treg.

¹⁶ Twomey, P. & Green, R. & Neuhoff, K. & Newbery, D. (2005): A Review of the Monitoring of Market Power the Possible Roles of TSOs in Monitoring for Market Power Issues in Congested Transmission Systems

$$CR_n = \sum_{i=1}^n MS_i$$

Përqindja e tregut dhe raporti i përqendrimit mund të jenë mashtruese në disa raste. Në rastin e përqindjes së tregut, një kompani me një përqindje tregu prej 25% në një treg shumë të segmentuar ka një fuqi tregu më të lartë se një kompani me një përqindje tregu 25%, e cila është vetëm kompania e dytë ose e tretë më e madhe në treg.

Një treg me një raport të përqendrimit të 3 kompanive më të mëdha (CR3) prej 90% mund të nënkuptojë se ka tre kompani po aq të mëdha me një përqindje tregu prej 30% secila, ose një treg ku një kompani ka një përqindje tregu prej 80%, dy kompani të tjera më të mëdha një përqindje tregu prej 5% secila, dhe pjesa tjetër e tregut është e segmentuar në kompani më të vogla. Në rastin e dytë, tregu është më i përqendruar drejt një kompanie, e cila mund të ushtrojë më shumë fuqi tregu.

Për të trajtuar këtë çështje, Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) është llogaritur për të vlerësuar përqendrimin e tregut. HHI llogaritet duke ngritur në katror përqindjet e tregut të të gjitha firmave dhe duke mbledhur vlerat e fituara pas ngritjes në katror¹⁷.

$$HHI = \sum_{i=1}^n (MS_i)^2$$

Vlerat e indeksit HHI mund të arrijnë deri në 10,000, në rastet kur një kompani e vetme kontrollon 100% të tregut. Sa më i lartë të jetë indeksi HHI, aq më i lartë është përqendrimi i tregut. Një indeks HHI afër 10,000 është tregues i një strukture monopoliste, ndërsa vlerat afër 0 tregojnë konkurrencë të përsosur.

Ndërsa nuk ka kufij të caktuar për vlerat HHI, në përgjithësi:

- HHI < 1,500 – tregon treg me konkurrencë të lartë
- 1,500 ≤ HHI < 2,500 – tregon treg me përqendrim mesatar
- 2,500 ≤ HHI – tregon treg me përqendrim të lartë¹⁸

Një kritikë e zakonshme ndaj indeksit HHI për tregjet me shumicë të energjisë elektrike është se ai është një indeks statik, i cili nuk merr parasysh nevojat për orë të kërkesës dhe ofertës. Një kompani mund të ketë një përqindje të tregut të prodhimit prej 20%, megjithatë modeli i saj i ofertës nuk përputhet me modelin e konsumit, dhe kështu kjo kompani është një marrëse e çmimeve. Nga ana tjetër, kur kapacitetet e prodhimit të sistemeve janë afër kufirit të kërkesës, një kompani mund të ushtrojë fuqinë e tregut dhe të bëhet një “furnizues kryesor” edhe me përqindje të ulëta të tregut. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë ndërprerjeve të prodhimit, orëve të kërkesës së lartë, etj. Për të kapërcyer këto kufizime përdoren Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI).

¹⁷ Rhoades, S. A. (1993). Herfindahl-Hirschman Index, The. Fed. Res. Bull., 79, 188.

¹⁸ Beus, M., Pavić, I., Štritof, I., Capuder, T. and Pandžić, H., 2018. Electricity Market Design in Croatia within the European Electricity Market—Recommendations for Further Development. *Energies*, 11(2), f. 346.

4.2. TREGUESI I FURNIZUESIT KRYESOR (PSI)

Në tregjet e energjisë elektrike, gjatë mungesës së prodhuesve të energjisë elektrike, ose gjatë kërkesës maksimale, edhe prodhuesit e energjisë elektrike me përçindje të ulëta të tregut mund të ushtrojnë fuqi të tregut.

Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) përfshin kërkesën përveç ofertës, për të matur fuqinë potenciale të tregut të pjesëmarrësve në treg. PSI-ja synon të tregojë nëse dhe sa shpesh një prodhues konsiderohet i domosdoshëm për të mbuluar kërkesën. PSI-ja mat se sa shpesh kapaciteti i një prodhuesi është më i madh se oferta e tepërt (diferenca ndërmjet ofertës totale dhe kërkesës).¹⁹

Për këtë raport, PSI-ja kufizohet në pordhimin vendor dhe nuk përfshin kapacitetet e importit. Kjo është për shkak se siç tregohet në Kapitullin 3.1. të këtij raporti, Kosova ka kapacitete të mjaftueshme interkonektive për të mbuluar teorikisht kërkesën maksimale në çdo kohë përmes importit, kështu që fuqia e tregut të prodhuesve në Kosovë është e kufizuar në çmimet e importit.

Me fjalë të tjera, PSI-ja në këtë rast mat se sa shpesh nevojitet një prodhues për të siguruar që e gjithë energjia të prodhohet në vend dhe sa shpesh mund të ushtrojë fuqinë e tregut për të rritur kostot, deri në çmimet e importit. PSI-ja llogaritet për çdo orë dhe është një indeks binar.

Një prodhues konsiderohet si kryesor (PSI = 1) nëse në atë kohë kërkesa tejkalon kapacitetin e kombinuar të të gjithë prodhuesve të tjerë në sistem.²⁰

$$PSI_{i,t} = \begin{cases} 1, & \text{if } D_t \geq \sum_{i \neq j} C_{j,t} \\ 0, & \text{if } D_t < \sum_{i \neq j} C_{j,t} \end{cases}$$

$$D_t = \text{Gjithsej kërkesa} - \text{Energjia e domosdoshme} = TD_t - E_{Kitka,t} - E_{Lumbardhi,t}$$

Ku:

- i – kompania prodhuese për të cilën e llogaritim PSI-në
- j – të gjitha kompanitë e tjera prodhuesve
- D_t – Kërkesa në kohën “t” (MW)
- C – Kapaciteti në dispozicion (MW)

Kërkesa konsiderohet si kërkesa reziduale, ose kërkesa totale në nivel transmetimi, e zbritur nga energjia e prodhuar nga era (WP Kitka), dielli dhe lumi i rrjedhshëm (HC Lumbardhi). Energjia nga këta gjeneratorë konsiderohet se duhet marrë në Kosovë dhe kapacitetet e tyre nuk mund të planifikohen apo kursehen për kushte më të përshtatshme tregu.

¹⁹ Bataille, M., Steinmetz, A. and Thorwarth, S., 2014. Screening Instruments for Monitoring Market Power in Wholesale Electricity Markets Lessons from Applications in Germany. SSRN Electronic Journal.

²⁰ Biggar, D. 2011. The theory and practice of the exercise of market power in the Australian NEM.

Për të siguruar ndërprerjet dhe kapacitetet teknike të KEK-ut merren parasysh Kosova A dhe Kosova B, kapaciteti i disponueshëm në kohën t konsiderohet si energjia e prodhuar nga KEK-u, në atë orë (MWh/h), ndërsa kapaciteti nga HC Ujmani si kapaciteti neto i HC Ujmani (32 MW)²¹.

4.3. INDEKSI I FURNIZIMIT REZIDUAL (RSI)

Ndërsa Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) është një indeks binar, i cili mat kur dhe nëse një prodhues është i domosdoshëm, Indeksi i Furnizimit Rezidual mat shtrirjen e "domosdoshmërisë" së firmave. Ai mat se deri në çfarë mase prodhuesit e tjerë në treg mund të mbulojnë kërkesën, pa kapacitetin e firmës.²²

RSI-ja llogaritet me anë të formulës në vijim:

$$RSI_{i,t} = \frac{\text{total available capacity} - \text{capacity}_i}{\text{market demand}}$$

Për të llogaritur RSI-në duhet të merren parasysh disa faktorë. Ngjashëm me PSI-në, konsiderohet se Kosova ka kapacitete të mjaftueshme transmetuese për të importuar energji elektrike për të mbuluar kërkesën maksimale gjatë gjithë kohës. Kështu, pjesëmarrësit e tregut mund të ushtrojnë fuqinë e tregut vetëm në një masë të caktuar, ose me fjalë të tjera, ata mund të rrisin çmimet deri në çmimin e importeve.

Gjithsej kapaciteti i disponueshëm është shuma e energjisë së prodhuar nga PE Kitka, HEC Lumbardhi në orë. Meqenëse kapaciteti në dispozicion duhet të marrë parasysh edhe ndërprerjet e prodhimit dhe kufizimet teknike, për termocentralet e KEK-ut, kapaciteti në dispozicion konsiderohet si energjia e dhënë në kohën "t" në orë (MWh/h). Ndërsa kapaciteti nga HC Ujmani konsiderohet si kapaciteti neto i HC Ujmani (32 MW)²³.

Kërkesa e tregut konsiderohet si kërkesa totale për energji elektrike në nivel transmetimi.

Nëse një firmë ka një vlerë RSI prej >100% në një kohë të caktuar, kjo do të thotë se në atë kohë, firmat e tjera mund të furnizojnë të gjithë energjinë elektrike të nevojshme për të mbuluar kërkesën, kështu që kjo firmë nuk konsiderohet kryesore (PSI = 0); ajo mund të vetëm ushtrojë fuqi të kufizuar në treg dhe ka pak ndikim në çmimin e tregut. Në mënyrë të ngjashme, nëse një firmë ka një RSI prej <100%, firmat e tjera nuk mund të ofrojnë energjinë e nevojshme elektrike për të mbuluar kërkesën. Sa më i ulët të jetë RSI për atë firmë, aq më shumë mund të ushtrojë fuqi në treg dhe anasjelltas.

Vlerat RSI do të paraqiten me një kurbë kohëzgjatjeje.

²¹ KOSTT, Kapacitetet e prodhimit të instaluar në Kosovë, 2021

²² Bataille, M., Steinmetz, A. and Thorwarth, S., 2014. Screening Instruments for Monitoring Market Power in Wholesale Electricity Markets Lessons from Applications in Germany. SSRN Electronic Journal.

²³ KOSTT, Kapacitetet e prodhimit të instaluar në Kosovë, 2021

5. VLERËSIMI I KONKURENCËS NË TREGUN ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

5.1. PËRSHKRIMI I TREGUT ME SHUMICË NË KOSOVË

Kapacitetet vendore të prodhimit të energjisë elektrike mbizotërohen nga termocentralet me qymyr, përkatësisht Kosova A dhe Kosova B, të cilat janë në pronësi të KEK-ut (në pronësi shtetërore). 95.2% e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë në vitin 2021 është prodhuar nga KEK-u. Pjesa e mbetur e energjisë elektrike është prodhuar nga Fabrika e Erës Kitka (1.3%), HC Ujmani (1.8%), HC Lumbardhi (1%) dhe FA Selaci (0.7%). Kjo është paraqitur në Figura 4.




Figura 4. Energjia elektrike lokale bruto e prodhuar në Kosovë në nivel të transmetimit, 2021²⁴

Tregu i shitjes me shumicë aktualisht vepron me kontrata dypalëshe. Tregjet e *një dite para* dhe ato *brenda ditës* nuk janë krijuar ende në Kosovë. Shumica e kapaciteteve prodhuese të Kosovës përdoren për konsum lokal nën Shërbimin e Furnizimit Universal, konsumatorët me çmime të derregulluara dhe për mbulimin e humbjeve në rrjet. Energjia elektrike importohet nga tregjet rajonale *një ditë para* ose *brenda ditës* me kontrata dypalëshe. Energjia e prodhuar nga KEK-u i shitet me prioritet Furnizuesit të Shërbimeve Universale. Gjatë procesit të ndarjes dhe privatizimit, një Marrëveshje për furnizim me shumicë²⁵ është nënshkruar ndërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Kompanisë aktuale Kosovare për Shpërndarjen dhe Furnizimin e Energjisë Elektrike (që më vonë u nda ligjërisht në KEDS dhe KESCO). Sipas nenit 5.2. të kësaj marrëveshjeje, KESCO mund të blejë energji elektrike nga KEK-u për qëllime të Furnizimit me Shërbimin Universal me prioritet. Energjia e mbetur shitet për të mbuluar humbjet në rrjet dhe tregtohet në treg, sipas procedurës së tregtimit të energjisë elektrike²⁶.

²⁴ KOSTT, Raporti vjetor, 2020

²⁵ https://me.rks-gov.net/repository/docs/Bulk_Supply_Agreement.pdf

²⁶ KOSTT, Procedura për tregtimin e energjisë elektrike, 2018

PE Kitka aktualisht i nënshtrohet skemës tarifore *feed-in*, kështu që energjia e prodhuar nga PE Kitka nuk shitet në tregun me shumicë, por u shpërndahet të gjithë furnizuesve në treg në proporcion me pjesën e konsumit të secilit furnizues. Që nga maji 2019, HC Ujmani ofron të gjithë prodhimin e tij të energjisë elektrike në tregun me shumicë, përmes ankandëve konkurruese, sipas procedurave të tregtimit të energjisë elektrike.²⁷

5.1.1. MARRËVESHJA E FURNIZIMIT ME SHUMICË NDËRMJET KEK-UT DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

Marrëveshja për furnizim me shumicë ndërmjet KEDS/KESCO dhe KEK-ut u nënshkrua si rezultat i transaksionit të privatizimit pas ndarjes vertikale të ndërmarrjes shtetërore KEK në vitin 2012.

Sipas Marrëveshjes për furnizim me shumicë, KEDS/KESCO do të blejë energji elektrike nga KEK-u jo ekskluzivisht për:

1. Funksionin e furnizimit publik.
2. Konsumatorët e kualifikuar, të përcaktuar me nenin 19.4 të Ligjit për Energjinë Elektrike të vitit 2010.
3. Çdo konsumator të kualifikueshëm i cili në çdo kohë mund të blejë energji elektrike nga KEDS-i me çmimin tarifor të rregulluar për energjinë elektrike të caktuar nga ZRRE; dhe
4. Për funksionimin efikas të sistemit KEDS (përfshirë energjinë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes) dhe mirëmbajtjen ose shërbimet tjera të nevojshme për funksionimin e sistemit KEDS.

Neni 5.6. i së njëjtës MFSH-je thekson se KEK-u mund ta shesë energjinë elektrike të cilën nuk e kërkon KEDS/KESCO te blerësit e tjerë, por vetëm pasi kjo energji t'i ofrohet fillimisht KEDS/KESCO-s për furnizim me energji elektrike për konsumatorët e lartpërmendur.

Pikat 1 deri në 3 më sipër përshkruajnë konsumatorët që zgjedhin të furnizohen nga Furnizuesi Universal ose Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Arsyeja kryesore e Marrëveshjes së Furnizimit me Shumicë ishte ofrimi i energjisë elektrike për konsumatorët vendas dhe mbrojtja e konsumatorëve nga çmimet e tregut rajonal dhe sigurimi i një furnizimi të qëndrueshëm për kompaninë e sapo privatizuar të shpërndarjes dhe furnizimit.

Çmimet e prodhimit në Kosovë *de jure* derregullohen, gjë që do t'i mundësonte KEK-ut të ushtrojë fuqi të lartë në treg. Megjithatë, meqenëse KEK-u është në pronësi publike të qeverisë që ushtron të drejtat e aksionarëve, çmimet e përdoruesve fundorë merren parasysh kur negociohen çmimet e shitjes me shumicë. Në raportin vjetor të KEK-ut për vitin 2020 përmendet se çmimet e energjisë elektrike për FSHU dhe për të mbuluar humbjet në rrjet nuk janë rritur nga viti 2019, për shkak të ndikimit të pandemisë tek përdoruesit fundorë. Çmimi me shumicë i energjisë elektrike të shitur nga KEK-u në vitin 2020 dhe 2021 për FSHU ishte 29.5 €/MWh, dhe 36 €/MWh për të mbuluar humbjet në transmetim dhe shpërndarje.

²⁷ ZRRE, Raporti për vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, 2018-2019

KEK-u në vitin 2020 ka eksportuar energji elektrike për 30.7 €/MWh.²⁸ Çmimi mesatar i importit në vitin 2020 në Kosovë ishte 57 €/MWh²⁹.

Çmimi i importeve u rrit ndjeshëm në vitin 2021, duke arritur majat deri në 620 €/MWh në tregun HUPEX. Tregu HUPEX zakonisht përdoret si referencë për shkak të likuiditetit të lartë dhe të përafërt me Kosovën. Çmimi mesatar ditor i energjisë elektrike në HUPEX, në krahasim me çmimin e energjisë elektrike të shitur nga KEK-u për FSHU-në sipas Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë është paraqitur në Figura 5.




Figura 5. Çmimi i energjisë elektrike të shitur në HUPEX dhe prej KEK-ut të FSHU-jë³⁰

Siç shihet në Figura 6, pjesa më e madhe e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK-u është e destinuar për KESCO-n, kryesisht për konsumatorët e tij si furnizues universal. Në vitin 2020, KEK-u ia shiti KESCO-s 65% të prodhimit neto të energjisë elektrike. Kjo shifër u rrit në vitin 2021 në 75.7%. Pjesa tjetër e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK-u shitet për të mbuluar humbjet në shpërndarje (9.4% në 2021), humbjet në transmetim (3.0% në 2021) dhe për eksport (11.8%).

²⁸ KEK, Raporti vjetor 2020

²⁹ ZRRE, Raporti vjetor 2020

³⁰ HUPEX Çmimet e tregut një ditë para, www.hupx.hu




Figura 6. Destinacioni i prodhimit neto të energjisë elektrike të KEK-ut.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë³¹ rekomandon ndërprerjen e MFSH-ve ndërmjet prodhuesve dhe furnizuesve ekzistues, pasi marrëveshjet e furnizimit me shumicë kanë të njëjtin ndikim negativ në tregje si kompanitë e integruara vertikalisht.

5.2. LLOGARITJA E INDEKSEVE PËR TREGUN ME SHUMICË NË KOSOVË

5.2.1. PËRQINDJA E TREGUT

Përqindja e tregut e prodhimit të energjisë elektrike, për nga vëllimi, në Kosovë përgjatë viteve është paraqitur në Figura 7. KEK-u ka pasur pjesëmarrje gati konstante në treg prej rreth ~95 - 97 %.

³¹ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Udhëzimet e politikave për rritjen e konkurrencës dhe likuiditetit në tregjet me shumicë të energjisë elektrike, duke përfshirë bursat e energjisë




Figura 7. Pjesëmarrja në treg për nga vëllimi i energjisë elektrike të gjeneruar.³²

Në vitin 2021 përqindja e KEK-ut në treg ra për 2%, kjo pritet të bjerë në vitet në vijim me rritjen e burimeve të ripërtëritshme në sistem.

Krahasuar me vendet e tjera të Evropës, Kosova ka një përqendrim të lartë të tregut në prodhimin vendor. Numri i kompanive kryesore prodhuese të energjisë elektrike (kompani që kanë një mbulim tregu prej të paktën 5% të totalit neto të energjisë elektrike kombëtare), dhe përqindja kumulative e tregut të këtyre kompanive për vendet evropiane është paraqitur në Figura 8. Vendet me një numër më të madh të kompanive kryesore të prodhimit të energjisë elektrike, të cilat gjithashtu kanë një përqendrim kumulativ më të ulët (më afër pjesës së sipërme majtas të Figura 8) karakterizohen si tregje më konkurruese. Vendet me një numër më të vogël të kompanive kryesore të prodhimit të energjisë elektrike, të cilat gjithashtu kanë përqindje të larta të tregut, konsiderohen si shtete shumë të përqendruara ose afër monopolit.

³² KOSTT, Raportet vjetore, 2014 - 2021




Figura 8. Numri i kompanive kryesore gjeneruese të energjisë elektrike dhe pjesëmarrja e tyre kumulative në treg.^{33 34 35}

5.2.2. INDEKSI HHI

Në bazë të prodhimit vendor të energjisë elektrike³⁶, vlerat e HHI-së për secilin vit në Kosovë janë paraqitur në Figura 9.

³³ Eurostat, Treguesit e tregut të energjisë elektrike, 2021

³⁴ Ofgem, Treguesit e tregut me shumicë

³⁵ ERE, Bilanci energjetik i Shqipërisë për vitin 2020

³⁶ KOSTT Raportet vjetore




Figura 9. Vlerat e HHI-së së prodhimit vendor të energjisë elektrike për Kosovën.

Vlera e HHI në 2021 ishte 9,070 dhe në 2020 indeksi i HHI ishte 9,371. Ky përfaqëson një treg me shumicë shumë të përqendruar. Vlerat e HHI-së për prodhimin vendor të energjisë elektrike nuk kanë ndryshuar ndjeshëm gjatë 5 viteve të fundit. Një rënie e lehtë e vlerave të HHI-së është parë në vitin 2018, që korrespondon me instalimin e termocentralit të erës Kitka dhe në vitin 2021 që korrespondon me instalimin e termocentralit të erës të Selacit. Tregu me shumicë i energjisë elektrike në Kosovë mbizotërohet nga KEK-u, i cili sipas Marrëveshjes për furnizim me shumicë është i obliguar që të gjithë energjinë elektrike të prodhuar në dispozicion t'ia shesë me prioritet Furnizuesit të Shërbimit Universal.

Bazuar në të dhënat në Figura 8, një vlerësim i vlerave të HHI-së për vendet evropiane është paraqitur në Figura 10. Këto vlerësime bazohen në të dhëna të kufizuara, kështu që diapazoni i vlerave të HHI-së mund të jetë i madh në disa raste.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor karakterizohet nga përqendrim i lartë i tregut edhe pas liberalizimit të tregut me shumicë. Kompanitë shtetërore si KEK në Kosovë, KESH në Shqipëri, EPCG në Mal të Zi, EPS në Serbi, ESM në Maqedoninë e Veriut dhe EPBiH, EPHZHB dhe EPRS (3 kompani shtetërore) në Bosnjë dhe Hercegovinë, mbizotërojnë prodhimin vendor të energjisë elektrike.




Figura 10. Vlerat e llogaritura të HHI-së për prodhimin e energjisë elektrike në vendet evropiane.

5.2.3. TREGUESI I FURNIZUESIT KRYESOR (PSI)

PSI është llogaritur për KEK-un (Kosova A + Kosova B) dhe HC Ujmani. PSI është llogaritur edhe për TC Kosova A dhe TC Kosova B, për të analizuar fuqinë e tregut të secilit termocentral veç e veç.

PSI-ja është llogaritur për çdo orë për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021 veçmas. Të dhënat e grumbulluara janë paraqitur në Figura 11.




Figura 11. PSI-ja e agreguar për prodhuesit e energjisë elektrike në Kosovë. Të dhënat për 2018 - 2021.³⁷

Nga Figura 11, shihet se KEK-u është konsideruar si furnizues kryesor gjatë të gjitha orëve të vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Me fjalë të tjera, prodhimi nga KEK-u ishte i nevojshëm për të shmangur importin e energjisë elektrike në Kosovë, dhe teorikisht KEK-u mund të ushtronte fuqi në treg në 100% të rasteve, për të rritur çmimet e tyre deri në çmimet e importit.

Nga ana tjetër, HC Ujmani shihej si kryesor në 61% të orëve në vitin 2021 dhe 50% të orëve në vitin 2020, edhe pse kishte një përqindje tregu prej vetëm 1.8% dhe 0.8% përkatësisht. HC Ujmani teorikisht mund të ushtronte fuqinë e tregut, të përcaktonte çmimet deri në çmimet e importit 50% (4,358 orë) – 61% (5,340 orë) të vitit. Për pjesën e mbetur të vitit, HC Ujmani nuk mund të ushtronte fuqi në treg dhe është marrës çmimi.

TC Kosova B dhe TC Kosova A konsiderohen gjithashtu si furnizues kryesorë në më shumë se 90% të kohës.

5.2.4. INDEKSI I FURNIZIMIT REZIDUAL

Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI) është llogaritur për çdo orë për KEK-un dhe HC Ujmani. Kurba e kohëzgjatjes së RSI-së për të dy termocentralet është paraqitur në Figura 12 dhe në Figura 13 si pasqyrë e hollësishme për KEK-un.




Figura 12. Përqindja kumulative e RSI-së për KEK-un dhe HC Ujmani, 2018-2021.




Figura 13. Përqindja kumulative e RSI-së për KEK-un, 2018 - 2021.

Siç shihet në Figura 12 dhe në Figura 13, KEK-u ka një shkallë të lartë të fuqisë në treg gjatë të gjitha orëve të vitit. Të gjithë prodhuesit e tjerë vendorë të kombinuar (përveç KEK-ut) mund të prodhonin më shumë se 10% të kërkesës totale vetëm gjatë 559 orëve të vitit 2021, dhe gjatë vetëm 168 orëve të vitit 2020. Për më tepër, në vitin 2021, prodhuesit e tjerë (përveç KEK-ut), nuk mundën kurrë të ofrojnë më shumë se

24% (20% në 2020) të kërkesës. Kështu, KEK-u ka një ndikim të rëndësishëm në çmimin mesatar të shitjes me shumicë të energjisë elektrike.

Kështu, ndërkohë që HC Ujmani kishte PSI prej 61% në vitin 2021 dhe PSI prej 50% në vitin 2020, ndikimi i tij në çmimet e energjisë elektrike në këto kohë është i kufizuar për shkak të sasisë së ulët të prodhimit në krahasim me kërkesën totale.

5.3. NDIKIMI I BASHKIMIT TË TREGUT ME SHQIPËRINË NË KONKURENCËN E TREGUT ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Për të adresuar mungesën e likuiditetit në tregun e shitjes me shumicë për shkak të marrëveshjeve të furnizimit me shumicë dhe pranisë së kontratave dypalëshe, vendet mund t'u kërkojnë pjesëmarrësve të tregut të tregtojnë ose të ofrojnë një pjesë ose të gjithë kapacitetin e tyre në bursën e energjisë. Kjo mund t'u imponohet prodhuesve, furnizuesve të energjisë elektrike dhe operatorëve të rrjetit (për të mbuluar humbjet). Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme që është subjekt i subvencioneve mund të marrë pjesë edhe në shkëmbimin e energjisë përmes Kontratave për Diferencë (CfD). Në Kosovë, kjo masë i nënshtrohet fillimit të funksionimit të platformës ALPEX me Shqipërinë.

Një treg i përbashkët me Shqipërinë, ku e gjithë energjia elektrike shitet përmes bursës së përbashkët të energjisë, do të zvogëlonte gjithashtu përqendrimin e tregut në tregun me shumicë për Kosovën, nëse kapacitetet nuk janë të lidhura me marrëveshjet e furnizimit me shumicë dhe gjithashtu duke mos supozuar mbingarkesa ndërmjet vendeve.

Tregu i prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri është paraqitur në Figura 15 dhe mbizotërohet nga kompania në pronësi shtetërore KESH (59.6%).




Figura 14. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të energjisë elektrike për vitin 2021 në Shqipëri.³⁸

³⁸ ERE, Bilanci energjetik i Shqipërisë, 2021




Figura 15. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të energjisë elektrike për vitin 2021 në tregun e përbashkët Shqipëri-Kosovë.

Shitja me shumicë CR₃ në Shqipëri aktualisht është 68,9%, me prodhuesin më të madh që prodhon 59,6%. CR₃ për një treg të përbashkët shqiptar dhe kosovar do të ishte 77%, ku prodhuesi më i madh (KEK) do të kishte një pjesë të tregut prej 39%.

Ndikimi në indeksin HHI i një tregu të përbashkët me shumicë është paraqitur në Figurën 16. Duke supozuar se nuk ka kufizime të kapacitetit të interkonektorëve, indeksi HHI i një tregu të përbashkët shqiptar dhe kosovar do të ishte dukshëm më i ulët se indeksi HHI për Kosovën që nga përqindja e tregut i KEK-ut është reduktuar nga 95.2% në 39% në një treg të përbashkët dhe dukshëm më i ulët se në Shqipëri. Kjo tregohet në Figura 16.




Figura 16. Ndikimi i tregut të përbashkët me shumicë në indeksin HHI.

Kombinimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë me një shembull ndarjeje horizontale të KEK-ut (ndërmjet Kosovës A dhe Kosovës B, ose duke futur termocentralet virtuale) do të siguronte një indeks HHI nën 2,500, i cili konsiderohet si një prag për "tregje të përqendruara mesatarisht".

Masa të ngjashme janë zbatuar në vende si Bullgaria, Polonia dhe Rumania. Një efekt i detyrimit të pjesëmarrësve për të tregtuar ose ofruar energji elektrike në bursën e energjisë ose në tregun e organizuar përpara, tregtimi i energjisë elektrike në Bursën e Energjisë në Poloni u rrit nga 4.2% në 2010, në 58.7% në 2011 (viti pas vendosjes së masës) dhe 61.8% në vitin 2012. Në të njëjtën kohë, energjia elektrike e tregtuar përmes kontratave dypalëshe ra nga 89.8% në 2010 në më pak se 40% në 2011. Në mënyrë të ngjashme në Rumani vëllimi i energjisë elektrike të tregtuar në tregun e ditës u rrit me 52.51%, një vit pas zbatimit të masë.

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike³⁹, neni 26, paragrafi 2, për të nxitur konkurrencën efektive në tregun e energjisë elektrike *“Rregullatori mund të përcaktojë programe për ofrimin në treg të sasive të caktuara të energjisë elektrike, sipas të cilit subjektet obligohen të shesin ose të vënë në disponim sasi të caktuara të energjisë elektrike ose mundësimin e qasjes në një pjesë të kapaciteteve të tyre prodhuese, furnizuesve të interesuar, për një periudhë kohore të caktuar. Para zbatimit, kjo masë duhet të shqyrtohet fillimisht përkitazi me rregullat e ndihmës shtetërore dhe të konsultohet me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.”*

Kjo masë mund të kombinohet me masa të tjera, si qasja e rregulluar në investimet historike, futja e termocentraleve virtuale (TV) dhe kufizimet e vetë-furnizimit. Në këtë rast Kosova mund të vendosë obligime ndaj KEK-ut për të shitur një pjesë të energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet e thëngjillit në tregun e ditës në vijim, ose përmes tregjeve të ardhshme, furnizuesve të tjerë të kualifikuar të energjisë elektrike. Për më tepër, Kosova mund të prezantojë termocentralet virtuale në treg për të shpërndarë në mënyrë efikase energjinë elektrike për blerësit.

Duhet të bëhet një analizë e detajuar e formës më të përshtatshme bazuar në specifikat e tregut në Kosovë. Për më tepër, ky detyrim duhet të përfshijë klauzola të rishikimit, ose periudha të caktuara të zbatueshmërisë.

6. VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË TREGUN ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

6.1. PËRSHKRIMI I TREGUT ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Aktualisht në Kosovë janë 8 furnizues të licencuar (duke përfshirë ata kryesorë), përkatësisht:

1. KESCO,
2. HEP Energjia,
3. GSA Energji,
4. Future Energy Trading and Exchange Dynamics,
5. Jaha Company,

³⁹ Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike

6. Korporata Energjetike e Kosovës - KEK (gjithashtu prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në Kosovë),
7. SharrCem, dhe
8. Enerco.⁴⁰

Prej 8 furnizuesve të licencuar, vetëm KESCO është aktiv.

6.1.1. FURNIZIMI I SHËRBIMIT PUBLIK DHE DERREGULLIMI I PËRDORUESVE FUNDORË

Në rast të konkurrencës së ulët në tregjet me pakicë dhe shumicë, sipas nenit 3.2. të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, ZRRE-ja rezervon të drejtën për të vendosur obligimet e shërbimit publik, për mbrojtjen e konsumatorëve dhe siguri energjetike. Për të garantuar sigurinë e furnizimit dhe mbrojtjen e konsumatorëve të cilët kanë të drejtë në tregun e rregulluar, ZRRE ka obliguar KESCO-n që të veprojë si Furnizues i Shërbimeve Publike.

Kosova aktualisht ka çmime të rregulluara për të gjithë konsumatorët e amvisërisë dhe jo të amvisërisë, me përjashtim të konsumatorëve të kyçur në rrjetin e OST-së (220 kV dhe 110 kV). Aktualisht vetëm 3 konsumatorë janë subjekt i çmimeve të çrregulluara, një konsumator i lidhur në 220 kV dhe 2 në 110 kV. Këta konsumatorë gjithashtu furnizohen nga furnizuesi aktual, KESCO.

Në vitin 2017, ZRRE nxori *Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë*⁴¹. Neni 8 i këtij udhëzuesi përcakton data specifike për derregullimin gradual të çmimeve të konsumatorëve. Konsumatorët e lidhur në 220 kV ishin të parët që hynë në tregun e derregulluar, të ndjekur nga konsumatorët në 110 kV (prill 2017), 35 kV dhe 10 kV (prill 2018). Për më tepër, udhëzuesi përmend se të gjithë konsumatorët fundorë kanë të drejtë të furnizohen me çmime konkurruese të tregut. ZRRE gjithashtu ka miratuar disa rregulla për të mundësuar konkurrencën në tregun me pakicë, si *Rregulla për Ndërrimin e Furnizuesit*⁴², *Rregulla për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal*⁴³, *Rregulla për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit*.⁴⁴

Afati i fundit (31 mars 2021) që synon të derregullojë çmimet për konsumatorët e kyçur në 35kV dhe 10kV, të cilët plotësojnë kriteret e të ardhurave vjetore mbi 10 milionë euro dhe më shumë se 50 punonjës, u shty për një kohë të pacaktuar. ZRRE ka kërkuar nga KESCO që të vazhdojë furnizimin e konsumatorëve në 35kV dhe 10 kV në kuadër të Shërbimit të Furnizimit Universal, me arsyetimin e ndikimit të pandemisë në financat e kompanive.

Gjatë kësaj tentative, ZRRE ka zhvilluar disa sesione informuese me konsumatorët.

Sipas intervistave, vetëm disa nga furnizuesit e licencuar paraqitën oferta për konsumatorët. Për shkak të disa vonesave të mëparshme në derregullimin e tregut, disa furnizues hezituan të investonin burime në

⁴⁰ ZRRE, Regjistri i licencave të furnizimit të lëshuara në vitin 2021

⁴¹ ZRRE, Udhëzuesi për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, 2017

⁴² ZRRE, Rregulla e ndërrimit të furnizuesit, 2016

⁴³ ZRRE, Rregulla për përcaktimin e të hyrave të Furnizuesit të Shërbimit Universal (Rregulla e çmimoreve të FSHU-së), 2017

⁴⁴ ZRRE, Rregulla për furnizuesin e mundësisë së fundit, 2017

përgatitjen e ofertave për konsumatorët pasi kishte pasiguri nëse këta konsumatorë do të derregulloheshin, duke ndikuar negativisht në procesin e derregullimit.⁴⁵

Ofertat bazoheshin në çmimet e importit dhe në disa raste edhe në prodhimin vendor. Sipas studimit “Pengesat ndaj liberalizimit të tregut me pakicë”, mesatarisht konsumatorët të cilët janë të detyruar të hyjnë në tregun e derregulluar konsumojnë 74% të energjisë elektrike gjatë orëve të pikut (kur Kosova importon energji elektrike) dhe 26% gjatë orëve jashtë pikut. (kur Kosova eksporton energji elektrike). Kështu, teprica e energjisë elektrike nga MFSH-ja (nga KEK-u) mund të furnizojë mesatarisht vetëm 26% të kërkesës së tyre. Për më tepër, pasi që nominimi i kapaciteteve në Kosovë bëhet në baza ore, furnizuesit nuk mund të planifikojnë dhe të mbështeten në prodhimin e mbetur nga KEK-u kur dorëzojnë oferta për konsumatorët.

Në të gjitha rastet ofertat e paraqitura nga furnizues të ndryshëm ishin më të shtrenjta se çmimi i tregut të rregulluar, gjë që shkaktoi hezitim të konsumatorëve. Është raportuar se disa konsumatorë kanë nënshkruar parakontrata me një furnizues alternativ përpara se të shtyhej ky afat. Këta konsumatorë u kthyen në tregun e rregulluar pas shtyrjes së afatit për derregullim të detyruar.

6.1.2. FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Përveç Furnizuesit Universal, i cili siguron energji për konsumatorët të cilët nuk janë të obliguar dhe nuk dëshirojnë të hyjnë në treg, ZRRE-ja zgjedh edhe Furnizuesin e Mundësisë së Fundit. Sipas nenit 9.1 të Rregullës së ZRRE-së nr. 08/2017 për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit⁴⁶, Furnizuesi i mundësisë së fundit (FMF) do të furnizojë konsumatorët që mbeten pa furnizues në rrethanat e mëposhtme:

1. Furnizuesi i tyre ka falimentuar ose është në likuidim.
2. Licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përgjithmonë ose përkohësisht ose ka pushuar së qeni e vlefshme (ka skaduar).
3. Konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e një furnizuesi të ri pas përfundimit të kontratës me atë të mëparshëm.

Furnizuesi i mjetit të fundit zgjidhet përmes një skeme konkurruese. Metodologjia e çmimeve dhe marzhet me pakicë të propozuara nga FMF-ja janë rishikuar nga ZRRE. Çmimi i energjisë elektrike i FMF-së duhet të jetë më i lartë se çmimi i tregut për të nxitur konsumatorët të gjejnë furnizues alternativë.

Në vitin 2017 ZRRE ka iniciuar një procedurë konkurruese për përzgjedhjen e furnizuesit të mjetit të fundit.⁴⁷ Asnjë furnizues nuk mori pjesë në asnjërin prej dy raundeve të tenderimit. Rrjedhimisht, me anë të vendimit V_1074_2018⁴⁸, ZRRE e caktoi KESCO-n si Furnizues të Mundësisë së Fundit për një periudhë trevjeçare (dhjetor 2018 – dhjetor 2021). Procedura e fundit e tenderimit për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit u shpall më 4 tetor 2021⁴⁹.

⁴⁵ Intervistat me furnizuesit e energjisë elektrike.

⁴⁶ ZRRE, Rregulla nr. 08/2017 për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

⁴⁷ ZRRE, Vendimi V_910_2017

⁴⁸ ZRRE, Vendimi V_1074_2018

⁴⁹ ZRRE, Vendimi V_1471_2021

6.2. PJSËMARRJA NË TREG DHE INTEKSI HHI

KESCO është furnizuesi i vetëm aktiv në treg, duke pasur një përqindje prej 100% të tregut me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë për konsumatorët e amvisërisë dhe industriale gjatë vitit 2020 dhe 2021. Krahasimi i numrit të furnizuesve kryesorë të energjisë elektrike dhe pjesës së tyre kumulative të tregut në shitje me pakicë sektori është paraqitur në Figura 17.

Furnizuesit kryesorë të shitjes me pakicë të energjisë elektrike konsiderohen furnizues me përqindje në treg prej >5%. Siç shihet nga Figura 17, tregu me pakicë është shumë monopolist, që e bën të krahasueshëm me vende ishullore si Qipro dhe Malta.




Figura 17. Numri i shitësve kryesorë me pakicë të energjisë elektrike dhe pjesëmarrja e tyre kumulative në treg, 2019⁵⁰ dhe 2021 për Kosovën.

Indeksi HHI për tregun me pakicë, jo-amvisëri dhe amvisëri, në Kosovë është 10,000 që përshkruan gjithashtu një treg monopolist. Indekset HHI të tregut me pakicë për konsumatorët e amvisërisë në vendet evropiane janë paraqitur në Figura 18 për krahasim.

⁵⁰ Eurostat, Treguesit e tregut të energjisë elektrike, 2019




Figura 18. HHI dhe CR3 për tregun e amvisërive bazuar në pikat matëse në energji elektrike – 2018-2020⁵¹

Indekset HHI të tregut me pakicë për konsumatorët jo-amvisëri në vendet evropiane janë paraqitur në Figura 19 për krahasim.




Figura 19. HHI dhe CR3 për tregun jo të amvisërive në energjinë elektrike – 2018-2020⁵²

Të dhënat nga Figura 18 dhe Figura 19, tregojnë se tregjet e jo-amvisërisë janë më konkurruese për sa i përket ofertës me pakicë sesa tregjet e amvisërisë në shumë nga vendet e listuara. Ndërsa 16 nga 24 vende kanë vlera HHI më të larta se 2000 në tregun e amvisërisë, vetëm 9 vende nga 24 kanë vlera të larta HHI për tregjet e jo-amvisërisë. Për më tepër, në shumicën e vendeve tendenca nga viti 2018 – 2020 është një rritje e konkurrencës si në tregjet e amvisërisë, ashtu edhe në ato të jo-amvisërisë.

⁵¹ ACER, Raporti vjetor i rezultateve të monitorimit të tregjeve të brendshme të energjisë elektrike dhe gazit natyror në vitin 2020, 2021

⁵² ACER, Raporti vjetor i rezultateve të monitorimit të tregjeve të brendshme të energjisë elektrike dhe gazit natyror në vitin 2020, 2021

Bazuar në pjesën e tregut dhe indeksin e llogaritur HHI, tregu i shitjes me pakicë në Kosovë është mjaft i përqendruar. Asnjë segment i tregut me pakicë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në vendimin e ZRRE-së V_342_2011.

“III. ... një treg përkatës konsiderohet si konkurrues nëse i plotëson kriteret në vijim:

- *Numri i furnizuesve në një treg përkatës, me përjashtim të furnizuesit publik, duhet të jetë 3 ose më shumë; dhe*
- *Përqindja e tregut të mbuluar nga furnizuesit, me përjashtim të furnizuesit publik, duhet të jetë mbi 30%”.*

Ndërsa numri i furnizuesve të regjistruar është 8, vetëm një është aktiv. Për më tepër, furnizuesi i vetëm aktiv u shërben 100% të konsumatorëve për sa i përket pikave të kyçjes dhe vëllimit të energjisë elektrike.

Pengesat kryesore drejt liberalizimit të tregut me pakicë, të gjetura në raportin “Pengesat ndaj liberalizimit të tregut me pakicë në Kosovë”, janë:

- 1) Pasiguria rregullatore dhe legjislative – Precedent i shtyrjes së afateve të derregullimit.
- 2) Konkurrenca e kufizuar e tregut me shumicë dhe qasja në kapacitetet prodhuese vendore – Mungesa e likuiditetit në tregun e shitjes me shumicë dhe prodhimi vendor i besueshëm i energjisë në dispozicion.
- 3) Ndikimi i çmimeve të rregulluara të përdoruesve fundorë – Çmime të ulëta të rregulluara për përdoruesit fundorë në krahasim me çmimet e tregut.
- 4) Mungesa e qasjes në informacion nga konsumatorët dhe furnizuesit - Mungesa e qendrave të të dhënave dhe profileve standarde të ngarkesës për konsumatorët pa matës inteligjentë
- 5) Mungesa e qasjes në informacion nga konsumatorët fundorë – Mungesa e mjeteve të krahasimit të çmimeve
- 6) Sfidat për furnitorët e rinj për të tërhequr konsumatorë për shkak të ndarjes ligjore të KESCO-s dhe KEDS-it.

6.3. NIVELET E NDËRRIMIT TË FURNIZUESIT

Rregulla e Ndërrimit të Furnizuesit⁵³, e nxjerrë në tetor 2016 nga ZRRE, përcakton se si konsumatorët përfundimtarë mund të ndërrojnë furnizuesin e tyre. Ky rregull përcakton gjithashtu procedurat, institucionet përgjegjëse dhe afatet për të përpunuar një ndërrim furnizues.

Sipas “Udhëzimit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë” (janar 2017), neni 8:

“1.5. Të gjithë konsumatorët fundorë do të kenë të drejtën që të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues nga momenti i aprovimit të këtij udhëzuesi.”

⁵³ ZRRE, Rregulla për ndërrimin e furnizuesit, 2016

Deri më sot asnjë konsumator përfundimtar nuk e ka ushtruar të drejtën e tij për të ndërruar furnizuesin e energjisë elektrike. Tre konsumatorët e derregulluar, të cilët nuk janë pjesë e tarifave të Furnizuesit Universal (të rregulluar), aktualisht furnizohen nga KESCO në detyrë, e cila është edhe Furnizuesi Universal.

Vlen të theksohet se gjatë rritjes së çmimit të energjisë elektrike në tregjet evropiane dhe rajonale (TM3 – TM4 2021), NewCo Ferronikeli, i cili është një nga konsumatorët e furnizuar me çmime të derregulluara, ka ndërprerë prodhimin për shkak të çmimit të lartë të energjisë elektrike të importuar. Kompania nuk ka ndryshuar furnizuesin e saj gjatë kësaj periudhe.

7. PËRFUNDIME

Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë në Kosovë i është nënshtruar reformave gjatë 2 dekadave të fundit. Kosova ka kaluar nga një treg i integruar vertikalisht në pronësi të shtetit, në krijimin e një rregullatori të pavarur, ndarjen vertikale të operatorit aktual dhe futjen e kompanive të veçanta për prodhim, transmetim dhe furnizim. Kompanitë që operojnë në tregjet natyrore monopoliste, si transmetimi dhe distribucioni, do të vazhdojnë të mbikëqyren nga ZRRE. ZRRE synon të prezantojë konkurrencën në tregje si tregjet me shumicë (prodhim) dhe pakicë (furnizim).

Bazuar në legjislacionin primar, është bërë vlerësimi i konkurrencës për shitje me shumicë dhe pakicë.

Vlerësimi bazohet në llogaritjen e indekseve të përqendrimit të tregut, të tilla si përqindja e tregut (MS), raporti i përqendrimit (CRn), Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI), Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI).

Bazuar në analizën, përfundimet janë:

- Tregu i shitjes me shumicë është shumë i përqendruar me një përqindje të tregut të prodhuesit më të madh (KEK) prej 96.8% në 2020 dhe 95.2% në 2021. Kjo përqindje e tregut ka mbetur pothuajse konstante gjatë 10 viteve të fundit. Indeksi HHI për 2020 dhe 2021 është përkatësisht 9371 dhe 9070, duke përshkruar një treg shumë të përqendruar.
- Sipas indekseve PSI dhe RSI, KEK mund të ushtrojë fuqi të lartë në treg gjatë të gjitha orëve të vitit dhe mund të rrisë çmimet deri në çmimet e importit në çdo kohë të caktuar. HC Ujmani mund të ushtrojë fuqi të kufizuar në treg gjatë 50% të orëve të vitit në vitin 2020 dhe 61% të orëve në vitin 2021.
- Nga 8 furnizues të regjistruar, vetëm KESCO është aktive, duke u shërbyer të gjitha segmenteve të tregut me pakicë në Kosovë.
- Obligimi për Furnizuesin e Shërbimeve Publike i është lëshuar KESCO-s nga ZRRE. Obligimi i furnizuesit të mundësisë së fundit i është lëshuar gjithashtu KESCO-s nga ZRRE, pas një procedure konkurruese pa aplikantë.
- Në të gjitha segmentet e tregut me pakicë KESCO ka përqindje prej 100% për nga pikat e furnizimit të kyçjeve dhe vëllimit të energjisë elektrike të furnizuar.
- Konsumatorëve të derregulluar u janë ofruar çmime të lidhura drejtpërdrejt me çmimet e importit, gjë që shkaktoi hezitim të zhvendosjes nga sektori i rregulluar.
- Asnjë konsumator nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ndërrimit të furnizuesit në asnjërin segment të tregut me pakicë.
- Asnjë segment i tregut me pakicë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Vendimin e ZRRE-së V_342_2011 për t'u konsideruar si konkurrues.
- Për periudhën e shqyrtimit, bazuar në treguesit e analizuar, tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë shfaq mungesë konkurrence dhe përqendrim të lartë.